



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORIA E LEGJISLACIONIT DHE SIGURISË

Nr. 226/prot.
1

Tiranë, më 11.11.2023

VENDIM

Nr. 106 , datë 11.11.2023

PËR

**PUBLIKIMIN E LISTËS SË TRANSPORTUESVE AJRORË QË JANË
SUBJEKT I NDALIMIT NË OPERIM BRENDA KOMUNITETIT DHE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË OSE JANË SUBJEKT I KUFIZIMEVE
OPERACIONALE**

Bazuar në nenin 8 dhe Kapitullin II të Urdhërit të Ministrit Nr 77, datë 17.07.2012 për miratimin e rregullores “Mbi kriteret e përbashkëta për përcaktimin e një liste të BE-së për transportuesit ajrorë, të cilëve u ndalohet operimi brenda BE-së dhe ZPAE-së, si dhe mbi informimin e pasagjerëve për identitetin e këtyre transportuesve ajrorë”, dhe në mbështetje të Nenit 14, të Ligjit Nr. 53/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”,

VENDOSA

1. Publikimin në faqen e AAC, të Listës A dhe Listës B të Bashkimit Evropian të transportuesve ajrorë, të cilëve brenda Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë:
 - a) u ndalohet operimi apo
 - b) u kufizohet operimi me një avion të caktuar apo tip avioni të caktuar.
2. Ky publikim do të bëhet nëpërmjet linkut të lidhur direkt me faqen zyrtare të Komisionit Evropian https://transport.ec.europa.eu/transport-themes/eu-air-safety-list_en.
3. Drejtoria e Rregullimit Ekonomik do të bëjë përditësimin e vazhdueshëm të informacionit mbi këtë listë në faqen zyrtare të AAC-së dhe do të njoftojë transportuesit ajrorë shqiptarë dhe operatorët aeroportual për t’ju referuar kësaj liste.
4. Transportuesit Ajrorë shqiptarë dhe operatorët aeroportualë duhet të sjellin në vëmendje të udhëtarëve listën e BE-së, nëpërmjet faqeve të tyre të internetit dhe zyrat e tyre.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR EKZEKUTIV

Maksim Et’hemaj

